



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.14, datë 29/05/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME
INDUSTRIALE ME NR.SERIE:00002, MIRATUAR NGA KBU MAT
ME VENDIM NR.4, DATË 27.04.2017, SUBJEKTIT “TETE
ALBANIA TUNNEL MINING” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime industriale me Nr.serie:00002, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.4, datë 27.04.2017, subjektit “Tete Albania Tunnel Mining” sh.p.k, me vendndodhje, Fshati Gurth-Spaç, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e burimit (KRGJSH)

- X= 503853.1; Y= 4640957.8; Z=515 m.m.n.d;

- Prurja mesatare : $Q_{mes} = 22.2$ l/s
- Sasia e ujit në përdorim : $Q = 4.8$ l/s
- Qëllimi i përdorimit : Industriale, Fabrikë Pasurimi mineral bakri.
- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Në Shtratin e përroit të Spaçit degë e lumit Fan.

3. Subjekti të aplikojë për t'u pajisur me autorizim për shkarkimin e ujërve të përdorur industriale sipas formularit Nr.41 të VKM-së nr.550, datë 15.7.2020.
4. Kjo leje për përdorimin e burimit ujorë do të hy në fuqi pasi subjekti të pajiset me autorizim për shkarkimin e ujërve të përdorur industriale sipas pikës 3 të këtij vendimi.
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

